

Takim ndërinstytucional mbi përgatitjen e planeve të përbashkëta të punës në kuadër të zbatimit të Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur 2022-2026

Në datë 3 tetor 2023, përfaqësues nga Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, morën pjesë në takim të organizuar nga Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, në kuadër të zbatimit të planeve të përbashkëta të punës ndërmjet QPKMR dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Në këtë takim u diskutuan masat dhe aktivitetet ku QPKMR dhe DPB janë institucione përgjegjëse në zbatim të Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur 2022-2026, si dhe realizimi i një plani pune të përbashkët ndërmjet QPKMR dhe DPB për të rinjtë e grup moshës 18-21 vjeç që janë në prag lirim nga IEVP-të.

